



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 20.05.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **15.05.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "D & T Group" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Autoambulanca BLS për nevoja të QKMF-ve në kuadër të KPSH" me nr. prokurimi 206-24-3961-1-1-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Pranohet**, si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "D & T Group" SH.P.K e dt. 15.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Autoambulanca BLS për nevoja të QKMF-ve në kuadër të KPSH" me nr. prokurimi 206-24-3961-1-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë të datës 24.04.2024;
2. Korrigjohet, Njoftimi për Kontratë i datës 24.04.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, do të korrigjoj specifikat teknike për aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "D & T Group" SH.P.K me date 15.05.2024 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me Autoambulanca BLS për nevoja të QKMF-ve në kuadër të KPSH" me nr. prokurimi 206-24-3961-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 20.05.2024 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE "D & T Group" SH.P.K:

Neni 28 Specifikimet teknike, par. 2.; Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

KERKESE PER RISHQYRTIM

Ne D&T Group SH.P.K. e bejme kete kerkese per rishqyrtim per arsye se pretendojme se A.K. nuk ka vepruar ne perputhshmeri te plote me Ligji Nr. 04/L-042

PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 pasi qe Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME te dosjes se tenderit ne fjale ka hartuar dhe publikuar specifikime teknike te cilat favorizojne nje operator ekonomik dhe diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Kjo dukuri verehet me shume te pozicioniet e listuara me poshte te cilat kerkojme nga autoriteti kontraktues qe ti rishikoj dhe te bej ndrryshimin e tyre ku perjashtohet favorizimi i nje ofertuesi te vetem:

Pretendimi nr.1

Eshte kerkuar nga A.K.: Vehicle Operation, Performance and Physical Characteristics - Tank Capacity: 90 litres sub tank 40 Litres (Basic Life Support Ambulance) - Kerkojme nga A.K. qe te largoj nga specifikimi teknik sub tank (rezervuarin shtese) pasi qe kapaciteti prej 90 litrash eshte mese i mjaftueshem duke marre parasysh shpenzimet mesatare te ulta te automjeteve te cilat jane te prodhimit te ri dhe poashtu prodhuesit e njohur boteror te automjeteve qe ofrojne automjetet ne perputhshmeri specifikimin teknik te kerkuar nuk e ofrojne kete veçori dhe nuk e perdorin si standard te prodhimit por vetem mund te modifikohet nga modifikues te automjeteve. Poashtu një rezervuar shtesë prej 40 litrash do të rrisë peshën e makinës, duke e bërë më të vështirë për të menaxhuar dhe për të përcjellë pacientët me siguri dhe efikasitet.

Pretendimi nr.2

Eshte kerkuar nga A.K.: Transmission: Automatic – Kerkojme nga A.K. qe te ndryshoj kete kerkese dhe te lejoj te ofertohej edhe transimssioni Manual, per arsye se Automjetet me transmision manual kanë një çmim më të ulët të mirëmbajtjes në krahasim me ato me transmision automatic, automjetet me transmision manual jane më të përshtatshme për detyrat specifike të punës te cilat do te perdoren keto automjete (autoambulance) Në situata emergjente, siç janë terrenet e vështira ose trafiku i rënduar, transmisioni manual ofron një gradë më të lartë të kontrollit për shoferin e cila eshte shume rëndësishme për situatat kur duhet të manovrohet me shpejtësi dhe precizion në hapësirat e ngushta ose të pamëdha, në raste kur kontrolli manual mund të jetë i nevojshëm për të ruajtur qetësinë e pacientit apo për të ndërmarrë veprime të menjëhershme në kohë emergjente, transmisioni manual jep më shumë fleksibilitet dhe kontroll për ekipin e shërbimit emergjent, për shembull, në terrene të vështira ose në situata ku nevojitet kontroll i shtuar mbi fuqinë e motorit. Kjo do të thotë që lejimi i ofertave edhe me automjete me transmision manual do

të sjellë mundësi për zgjedhje për autoritetin kontraktues dhe nuk do të favorizoj apo diskriminoj operatorët ekonomik të interesuar për të ofertuar në këtë procedurë të prokurimit.

Pretendimi nr.3

Eshtë kërkuar nga A.K.: The overall width of the ambulance should approximately 2000mm, excluding mirror, lights and safety accessories. – Kërkojmë nga A.K. që të bëjë ndryshimin e këtij specifikimi teknik duke lejuar që gjerësia e përgjithshme e autoambulancës të jete min 2000mm dhe max 2100mm. Lejimi i një gamë më të gjerë të gjerësisë së përgjithshme të automjetit do të sigurojë një trajtim të barabart për të gjithë operatorët ekonomikë që janë të interesuar për të ofertuar në procedurën e prokurimit. Kjo do të përmbushte kërkesën për barazi dhe mosdiskriminim në procesin e prokurimit, duke u siguruar që të gjithë operatorët ekonomikë të kenë mundësinë e barabartë për të konkurruar dhe për të siguruar kontratën.

Pretendimi nr.4

Për shkak të kërkesave optimale të vendosura për pajisjet mjekësore të autoambulancës të cilat janë të kërkuara nga A.K. përkatësisht tek Aneksi I SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME TECHNICAL SPECIFICATIONS BASIC LIFE SUPPORT AMBULANCES (Types A2)/ Equipment for Basic Life Support, për të siguruar një proces të drejtë dhe të barabartë për operatorët ekonomikë që janë të interesuar për të ofertuar, autoriteti kontraktues duhet të ndryshojë specifikimet teknike me dhe të lejojë një tolerancë prej $\pm 5\%$. Lejimi i një tolerancë prej $\pm 5\%$ për specifikimet teknike të pajisjeve mjekësore nuk do të favorizonte vetëm një prodhues, por dallim nga specifikimi teknik aktual i cili favorizon vetëm një prodhues specifik apo një operator ekonomik, kjo për shkak se një tolerancë e tillë do të lejonte për përdorimin e pajisjeve të prodhuara nga një gamë më e gjerë e prodhuesve të njohur që përputhen me specifikimet teknike të caktuara.

Dëmet materiale

Nëse A.K. nuk ndërmerr veprimet e duhura dhe nëse nuk zbatohet LPP, në D&T Group do të përballemi me dëme materiale të konsiderueshme të cilat do të kalkulohen.

Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues në lidhje me pretendimin Ankimore

Konstatojmë se pretendimet e juaja ankimore janë pjesërisht të bazuara, andaj AK-MSH lenden e ka pezulluar me statusin në apel.

Sa i përket transmisionit automatik të kërkuar, kjo është specifikuar nga ana e komisionit të cilin MSh e ka angazhuar për finalizimin e specifikave për këtë aktivitet dhe ky komision e ka kërkuar që Autoambulancat të kenë transmisionin automatik, megjithatë edhe kjo specifikë do të ri-shikohet.

Specifikat bazike janë marrë nga Banka Boterore, duke përfshirë edhe specifikat për të cilat ju pretendoni që nuk janë në rregull, si p.sh. rezervuari shtesë, gjerësia e automjetit, pajisjet mjekësore, etj.

Si perfundim AK-MSh do ti rishikoj specifikat teknike te pajisjeve, dimensionet, vleren e parashikuar dhe do ta beje korrigjimin e procedures, do ta caktojme daten e re per ofertim, duke i njoftuar te gjithë OE te interesuar.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit